



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT,
BUJQESISE, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

**RELACION PËR GJENDJEN DHE NDËRTIMIN E URËS MBI PËRROIN
"SHEHU" NË FSHATIN PAPËR-SOLLAK ,NJËSIA ADMINISTRATIVE PAPËR**

Mbështetur në kërkesën e banorëve të Lagjes së "Gjahtallarëve" dhe Njesisë Administrative Papër me nr.prot.100 datë 01/04/ 2026 dhe aktit të Kostatimit të mbajtur nga Sektori i Parandalimit, Verifikimit për Rastet e Fatkeqesive Natyrore dhe Koordinimit me Strukturat Vullnetare në SH.M.Z.SH më datë 06.04.2026, është konstatuar se është i nevojshme ndërtimi i një ure mbi përroin "Shehu". Ndërtimi i urës do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ku Bashkia Elbasan merr përsipër ndërtimin e këmbëve dhe speronave të urës tip "Bely" dhe Ministria e Mbrojtjes do të bëjë furnizimin dhe vendosjen e konstruksionit metalik të mbistrukturës kaluese të urës.

I.Ura mbi përroin "Shehu" në fshatin Papër Sollak , Njësia Administrative Papër, Bashkia Elbasan



Fig 1. Pozicioni gjeografik

OBJEKTI: “Ndërtimi i këmbëve dhe speronave të urës tip “Bely” në fshatin Papër-Sollak (Lgj.Shehu), Njësia Administrative Papër,Bashkia Elbasan.

VENDODHJA : Përroi “Shehu” ne fshatin Papër-Sollak , Njësia Administrative Papër, Elbasan

Qëllimi: Ndërtim i urës mbi Përroin “Shehu” do të shërbejë për lidhjen e banorëve të Lagjes së “Vjetër” me qendrën e Njesisë Administrative Papër si edhe do të siguroj aksesin e të gjithë nxënësve në shkollën 9-vjeçare “Hysen Pulaku.

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES

Akualisht kalimi mbi përroin “Shehu”, në lagjen e “Gjahtallarëve” të fshatit Papër-Sollak, nuk është i sigurt dhe paraqet vështirësi të konsiderueshme për banorët, veçanërisht gjatë periudhave me reshje intensive, kur niveli i ujit në përrua rritet dhe pengon lëvizjen e tyre. Mungesa e një ure funksionale vështirëson lidhjen ndërmjet lagjeve të fshatit dhe kufizon aksesin e banorëve drejt shërbimeve bazë.

Ndërtimi i urës së re mbi përroin “Shehu” do të shërbejë për lidhjen funksionale të tre lagjeve të fshatit Papër-Sollak, duke garantuar një kalim të sigurt për banorët gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, kjo urë do të mundësojë aksesin e rregullt dhe të sigurt të nxënësve drejt shkollës 9-vjeçare “Hysen Pulaku”, si dhe do të lehtësojë lëvizjen e mjeteve bujqësore dhe transportin e produkteve agro-bujqësore të zonës.

Gjendja ekzistuese paraqiten si në fotot e mëposhtme



Fig.1 Foto te gjendjes ekzistuese



Fig.2 Foto te gjendjes ekzistues



Fig.3 Foto te gjendjes ekzistues

PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve, specifikimet për objektin : “ Ndertim i kembeve te ures dhe speronave te ures tip beli ne fshatin Muriqan ,Njesia Administrative Gjergjan “ , Elbasan , jane bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.

Punoi: Ing.Arian Baku



MIRATOI
DREJTORIA E EMERGJENCEVE CIVILE
Ndricim Sinani

